PROGRAMI I TRANSPARENCËS
BASHKIA DEVOLL

VENDIMET, URDHËRESAT DHE URDHËRAT ME KARAKTER NORMATIV.
Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" , Organet enjësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave.
Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithëanëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.
Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtijligji.
Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillitpër rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të këtij ligji.
Bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, përkryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave,bashkia nxjerr urdhëresa, vendime dhe urdhra.
Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të Bashkisë Devoll i nënshtrohenverifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.
Urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e organeve të zgjedhura të bashkisë përkatëse janë tëdetyrueshme për zbatim nga kryetari dhe kryesia e fshatit.

Përditësuar në datë 16.03.2026